

VENDIM
Nr. 261, datë 29.4.2022

**PËR NJËSITË BAZË TË SISTEMIT NDËRKOMBËTAR TË NJËSIVE (SI), QË
DO TË PËRDOREN NË SHQIPËRI, NJËSITË QË RRJEDHIN PREJ TYRE,
SHUMËFISHAT DHE NËNFISHAT, NJËSITË SHITESË TË VENDOSURA
NDËRKOMBËTARISHT DHE MËNYRA E PËRDORIMIT TË TYRE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Republikën e Shqipërisë përdoren njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shitesë të vendosura ndërkombëtarisht, të përcaktuara në këtë vendim.

2. Mënyra e përdorimit të njësive të matjes, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përcaktohet në këtë vendim.

3. Në transportin ajror, detar dhe hekurudhor, krahas njësive të sistemit SI të paraqitura në këtë vendim, lejohen të përdoren edhe njësi të tjera të përcaktuara në konventa apo marrëveshje ndërkombëtare të këtyre llojeve të transporteve.

4. Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), janë:

4.1 Njësia e kohës: sekondë, simboli s, është njësia SI e kohës. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të frekuencës së ceziumit $\Delta\nu_{CS}$, frekuenca e tranzicionit në gjendjen themelore të atomit 133 të ceziumit, prej $9\,192\,631\,770$, kur shprehet në njësinë Hz, e cila është e barabartë me s^{-1} .

4.2 Njësia e gjatësisë: metër, simboli m, është njësia SI e gjatësisë. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të shpejtësisë së dritës në vakuum c prej $299\,792\,458$, kur shprehet në njësinë m/s, ku s përcaktohet në terma të $\Delta\nu_{CS}$ -së.

4.3 Njësia e masës: kilogram, simboli kg, është njësia SI e masës. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të konstantës *Planck* h prej $6.626\,070\,15 \times 10^{-34}$, kur shprehet në njësinë J.s, e cila është e barabartë me $kg\,m^2\,s^{-1}$, ku metri dhe sekonda përcaktohen në termat e c-së dhe $\Delta\nu_{CS}$ -së.

4.4 Njësia e rrymës elektrike: amper, simboli A, është njësia SI e rrymës elektrike. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të ngarkesës elementare prej $1,602\,176\,634 \times 10^{-19}$, kur shprehet në njësinë C, e cila është e barabartë me A s, ku sekonda përcaktohet në terma të $\Delta\nu_{CS}$ -së.

4.5 Njësia e temperaturës termodinamike: kelvin, simboli K, është njësia SI e temperaturës termodinamike. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të konstantes *Boltzmann* k prej $1,380\,649 \times 10^{-23}$, kur shprehet në njësinë J.K⁻¹, e cila është e barabartë me $kg\,m^2\,s^{-2}\,K^{-1}$, ku kilogrami, metri dhe sekonda përcaktohen në terma të h-së, c-së dhe $\Delta\nu_{CS}$ -së.

4.6 Njësia e sasisë së substancës: mol, simboli mol, është njësia SI e sasisë së substancës. Një mol përmban saktësisht $6,022\,140\,76 \times 10^{23}$ grimca elementare. Ky numër është vlera numerike e konstantes Avogadro, N_A , kur shprehet në njësinë mol⁻¹ dhe quhet numri i Avogadros.

Sasia e substancës, simboli n, i një sistemi është një masë e numrit të njësive themelore të

¹ Ky vendim përafron pjesërisht direktivën e Komisionit (BE) 2019/1258, datë 23.7.2019, që amendon për qëllim përshtatjen me progresin teknik, aneksin e direktivës së Këshillit 80/181/KEE, në lidhje me përkufizimet e njësive bazë të SI. CELEX nr.32019L1258. Gazeta Zyrtare e BE-së, L 196, datë 24 korrik 2019.

specifikuara. Një grimcë elementare mund të jetë një atom, një molekulë, një jon, një elektron, çdo grimcë tjetër ose grup i caktuar grimcash.

4.7 Njësia e intensitetit të dritës: kandela, simboli cd, është njësia SI e intensitetit të dritës në një drejtim të caktuar. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të efikasitetit të dritës së rrezatimit monokromatik të frekuencës 540×10^{12} Hz, Kcd, prej 683, kur shprehet në njësinë lm W^{-1} , e cila është e barabartë me cdsr W^{-1} , ose $\text{cdsr kg}^{-1} \text{ m}^{-2} \text{ s}^3$, ku kilogrami, metri dhe sekonda përcaktohen në terma të h-së, c-së dhe $\Delta\nu_{\text{Cs}}$ -së.

4.8 Madhësia, emri dhe simboli i njësive bazë SI jepen në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI). Njësitë e rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) formohen nga njësitë bazë nëpërmjet shprehjeve algjebrike, që lidhin madhësitë korresponduese.

5.1 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të cilat shprehen vetëm nga njësitë bazë të këtij sistemi matjeje, jepen në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.2 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të cilat shprehen me emra dhe simbole të veçanta jepen në tabelën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.3 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të cilat shprehen nga kombinimi i disa njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI me emra dhe simbole të veçanta, jepen në tabelën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (SI) shpreh shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive të matjes me ndihmën e parashtesave. Faktori i fuqisë, emri dhe simboli i parashtesave të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) jepen në tabelën nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Emri, simboli dhe vlera në njësi SI e njësive të pranuar për t'u përdorur me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) jepen në tabelën nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Emri, simboli, përkufizimi dhe vlera në njësi SI e njësive matëse të pranuar për t'u përdorur në Sistemin Ndërkombëtar të Matjeve SI, vlera e të cilave është përcaktuar në mënyrë eksperimentale, jepen në tabelën nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Emri, simboli dhe vlera në njësi SI e njësive të tjera të pranuar për t'u përdorur në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) jepen në tabelat nr. 8 (a), 8 (b) dhe 8 (c), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

10. Rregullat për përdorimin e drejtë të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) janë:

10.1 Çdo madhësi në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) ka një njësi të vetme, ndërsa e anasjella nuk është e vërtetë.

10.2 Vlerat e madhësive të quajtura pa përmasa shprehen vetëm me numra dhe paraqesin raportin e dy madhësive të së njëjtës natyrë.

10.3 Simbolet e njësive shkruhen me shkronja latine dhe në përgjithësi të vogla.

Në rastet kur emri i njësisë rrjedh nga një emër i përveçëm, shkronja e parë e simbolit shkruhet me shkronjë të madhe.

10.4 Emri i plotë i një njësie shkruhet me shkronjë të vogël.

10.5 Simbolet e njësive mbeten të pandryshuara, kur vlera e madhësisë ndryshon nga njësia.

10.6 Simbolet e njësive nuk ndiqen me pikë pas tyre, me përjashtim të rasteve kur ndodhen në fund të fjalisë.

10.7 Nëse një njësi shoqërohet me madhësi relative, duhet që ajo të tregohet vetëm me simbolin e vendosur prapa vlerës numerike.

10.8 Produkti i dy ose më shumë njësive shënohet me njëërën nga mënyrat e mëposhtme: N.m ose N m.

10.9 Kur një njësi e rrjedhur formohet nga pjesëtimi i dy njësive, përdoret një vijë e pjerrët

(/), një vijë horizontale ose eksponentë negativë.

10.10 Asnjëherë nuk përdoret në një rresht më shumë se një vijë e pjerrët, me përjashtim të rastit kur janë vendosur kllapat.

10.11 Shumëfishat dhe nënfishat e njësisë së masës formohen nga bashkimi i parashtesave me fjalën “gram”, simboli i të cilit është “g”.

10.12 Simbolet e parashtesave shkruhen me shkronja latine, pa hapësirë ndërmjet simbolit të parashtesës dhe simbolit të njësisë.

10.14 Nuk lejohet të përdoren parashtesa të përbëra, të formuara nga vendosja e shumë parashtesave.

10.15 Një parashtesë nuk lejohet të përdoret vetëm, pa njësinë.

10.16 Nëse simbolit të njësisë të ngritur në një fuqi i vihet një parashtesë, atëherë edhe parashtesa kuptohet që është e ngritur në atë fuqi.

10.17 Nuk lejohet zbatimi i parashtesave SI për njësitë këndore: “, ‘, apo për njësitë e kohës: min, h, d.

11. Vendimi nr. 1162, datë 13.8.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

Tabela nr. 1

NJËSITË BAZË SI

Madhësia	Njësia	
	Emri	Simboli
Koha	sekondë	s
Gjatësia	metër	m
Masa	kilogram	kg
Rryma elektrike	amper	A
Temperatura termodinamike	kelvin	K
Sasia e lëndës	mol	mol
Intensiteti i dritës	kandela	cd

Tabela nr. 1.1

Emri dhe simboli i veçantë i njësisë së temperaturës për shprehjen e temperaturës në Celsius.

Madhësia	Njësia	
	Emri	Simboli
Temperatura celsius	Celsius	°C

Temperatura Celsius përcaktohet si diferencë $t = T - T_0$ ndërmjet dy temperaturave termodinamike T dhe T_0 , ku $T_0 = 273,15$ K.

Një interval ose diferencë temperaturash mund të shprehet në kelvin ose në gradë celsius.

Tabela nr. 2

NJËSI TË RRJEDHURA NGA NJËSITË BAZË TË SISTEMIT SI

Njësi të rrjedhura të SI-së

Madhësia e rrjedhur	Njësia e rrjedhur	Simboli
- Sipërfaqja	metër katror	m ²
- Vëllimi	metër kub (a)	m ³
- Shpejtësia	metër për sekondë	m/s
- Nxitimi	metër për sekondë në katror	m/s ²
- Numri i valëve	një për metër	m ₋₁
- Densiteti	kilogram për metër kub	kg/m ³
- Vëllimi specifik	metër kub për kilogram	m ³ /kg

- Densiteti i rrymës	amper për metër katror	A/m^2
- intensiteti i fushës magnetike	amper për metër	A/m
- përqendrimi (i sasisë së lëndës)	mol për metër kub	mol/m^3
- shkëlqimi	kandela për metër katror	cd/m^2
- indeksi i thyerjes	një (numër)	1
- aktiviteti katalitik	katal	$kat=mol/s$

- a) Simboli “1” zakonisht nuk përdoret në kombinime me vlerën numerike.
- b) Njësitë e rrjedhura formohen nga shprehjet algjebrike, që përmbajnë veprime të shumëzimit dhe të ngritjes në fuqi të njësive bazë SI dhe të shumëzuara këto me një koeficient të barabartë me 1.

Tabela nr. 3

NJËSI TË RRJEDHURA TË SI-SË, ME EMRA DHE SIMBOLE TË VEÇANTA

Madhësia e rrjedhur	Njësia		Shprehja	
	Emri	Simboli	E shprehur në njësi të tjera të SI	E shprehur në njësi bazë të SI
Këndi plan	radian ^(a)	rad		$m \cdot m^{-1}$
Këndi në hapësirë	steradian	sr		$m^2 \cdot m^{-2}$
Frekuenca	herz	Hz		s^{-1}
Forca	njuton	N		$m \cdot kg \cdot s^{-2}$
Presioni, sforçimi	paskal	Pa	N/m^2	$m^{-1} \cdot kg \cdot s^{-2}$
Energjia, puna	xhaul	J	$N \cdot m$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2}$
Fuqia ⁽¹⁾ , fluksi energjetik	wat	W	J/s	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3}$
Ngarkesa elektrike	culon	C		$s \cdot A$
Diferenca e potencialit elektrik, Forca elektromotore	volt	V	W/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-1}$
Rezistenca elektrike	ohm	Ω	V/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-2}$
Përcjellshmëria	siemen	S	A/V	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^3 \cdot A^2$
Kapaciteti	farad	F	C/V	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^4 \cdot A^2$
Fluksimagnetik	veber	Wb	$W \cdot s$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
Densiteti i fluksit magnetik	tesla	T	$Wb \cdot m^{-2}$	$kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
Induktiviteti	henri	H	$Wb \cdot A^{-1}$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-2}$
Fluksi i dritës	lumen	lm	$cd \cdot sr$	cd
Ndriçimi	lux	lx	lm/m^2	$m^{-2} \cdot cd$
Aktiviteti i një burimi radioaktiv	bekerel	Bq		s^{-1}
Doza e përthithur, energjia specifike, indeksi i dozës së absorbuar	grej	Gy	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
Doza ekuivalente	sivert	Sv	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
Aktiviteti katalitik	katal	kat		$mol \cdot s^{-1}$

Në veçanti, njësitë SI të prejardhura mund të shprehen me emra të veçantë dhe simbole të dhëna në tabelën e mësipërme; për shembull, njësia SI e viskozitetit dinamik mund të shprehet si $m - 1 \cdot kg \cdot s - 1$ ose $N \cdot s \cdot m - 2$ ose $Pa \cdot s$.

(1)Emra të veçantë për njësinë e fuqisë: emri volt–amper (simboli “VA”), kur përdoret për të shprehur fuqinë e plotë të rrymës elektrike alternative, dhe var (simboli “var”), kur përdoret për të shprehur fuqinë elektrike reaktive. “var” nuk përfshihet në “GCPM resolutions”.

Tabela nr. 4

SHEMBUJ TË NJËSIVE TË RRJEDHURA SI, EMRAT DHE SIMBOLET E TË CILAVE SHPREHEN NGA KOMBINIMI I NJËSIVE TË RRJEDHURA TË SISTEMIT NDËRKOMBËTAR TË NJËSIVE (SI) ME EMRA DHE SIMBOLE TË VEÇANTA
Njësi të rrjedhura të SI

Njësia e rrjedhur	Emri	Simboli	Shprehur në terma të njësive bazë SI
- Viskoziteti dinamik	paskal sekond	Pa.s	$m^{-2}.kg.s^{-1}$
- Momenti i forcës	njuton metër	N.m	$m^2.kg.s^{-2}$
- Tensioni sipërfaqësor	njuton për metër	N/m	$kg.s^{-2}$
- Shpejtësia këndore	radian për sekondë	rad/s	$m.m^{-1}.s^{-1}= s^{-1}$
- Nxitimi këndor	radian për sekondë katror	rad/ s ⁻²	$m.m^{-1}.s^{-1}= s^{-2}$
- Densiteti i fluksit termik, Rrezatimi energjetik	vat për metër katror	W/.m ²	$kg.s^{-3}$
-Kapaciteti termik entropia specifike	xhaul për Kelvin	J/K	$m^2.kg.s^{-2}.K^{-1}$ $m^2.s^{-2}$
- Energjia specifike	xhaul për kilogram	J/kg	
- Përcjellshmëria termike	vat për metër kelvin	W/(m.K)	$m.kg.s^{-3}.K^{-1}$
- Energjia vëllimore	xhaul për metër kub	J/ m ³	$m^{-1}.kg.s^{-2}$
- Intensiteti i fushës elektrike	volt për metër	V/m	$m.kg.s^{-1}.A^{-1}$
- Ngarkesa elektrike vëllimore	kulon për metër kub	C/ m ³	$m^{-3}.s.A$
- Induksioni elektromagnetik	kulon për metër katror	C/ m ²	$m^{-3}.s.A$
- Përcjellshmëria dielektrike	farad për metër	F/m	$m^{-3}.kg^{-1}.s^{-4}.A^2$
- Përcjellshmëria magnetike	henri për metër	H/m	$m.kg.s^{-2}.A^{-2}$
- Energjia molare	xhaul për mol	J/m	$m^2.kg.s^{-2}.mol^{-1}$
- Entropia molare	xhaul për mol kelvin	J/(mol.K)	$m^2.kg.s^{-2}.K^{-1}.mol^{-1}$
kapaciteti termik molar			
- Ekspozimi ndaj rrezeve	kulon për kilogram	C/kg	$kg^{-1}.s.A$
- Fuqia e dozës së absorbimit	grej/s	Gy/s	$m^2.s^{-3}$
- Intensiteti i rrezatimit	Vat për steradian	W/sr	$m^4.m^{-2}.kg.s^{-3}$
- Luminishenca energjetike	Vat për metër katror steradian	W(m ² .sr)	$m^2m^{-2}.kg.s^{-3}= kg.s^{-3}$

Tabela nr. 5

SHUMËFISHAT DHE NËNFISHAT DHJETORË TË NJËSIVE TË MATJES TË SISTEMIT SI

Shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive formohen me anë të shumëzimit të faktorëve numerikë dhjetorë, me njësi të SI-së.

Faktorët numerikë tregohen me prefikse ose simbole të tyre, që vendosen para emrit të njësisë ose simbolit të tyre.

Faktori	Prefiksi	Simboli
10 ²⁴	jota	Y
10 ²¹	zeta	Z
10 ¹⁸	eksa	E
10 ¹⁵	peta	P
10 ¹²	tera	T
10 ⁹	giga	G
10 ⁶	mega	M
10 ³	kilo	k
10 ²	hekto	h
10	deka	da
10 ⁻¹	deci	d
10 ⁻²	centi	c
10 ⁻³	mili	m
10 ⁻⁶	mikro	μ
10 ⁻⁹	nano	n
10 ⁻¹²	piko	p
10 ⁻¹⁵	femto	f

10 ⁻¹⁸	ato	a
10 ⁻²¹	zepto	z
10 ⁻²⁴	jokto	y

Tabela nr. 6

NJËSITË QË JANË CAKTUAR NË BAZË TË SISTEMIT TË NJËSIVE SI, POR NUK JANË SHUMËFISHA APO NËNFISHA DHJETORË TË TYRE

Madhësia	Njësia		
	Emri	Simboli	Vlera
Këndi plan	rrotullim *		1 rrotullim = 2π rad
	gradë* ose gon*	gon*	1 gon = $\frac{\pi}{200}$ rad
	gradë	°	1 = $\frac{\pi}{180}$ rad
	Minutë këndore	'	1' = $\frac{\pi}{10\,800}$ 10 800rad
	Sekondë këndore	"	1 = $\frac{\pi}{648\,000}$ 648 000rad
Koha	minutë	min	1 min = 60 s
	orë	h	1 h = 3 600 s
	ditë	d	1 d = 86 400 s

(1) Karakteri (*) mbas një emri njësie ose simboli tregon se nuk figuron në listat e hartuara nga CGPM-ja, CIPM-ja ose BIPM-ja. Kjo vlen për të gjithë këtë shtojcë.
(2) Asnjë simbol ndërkombëtar nuk ekziston.

Shënim. Prefikset e paraqitura në tabelën 5 do të përdoren me njësitë dhe simbolet e masës, të vëllimit, të presionit në ajër e në lëngje dhe të njësisë gradë të këndit plan të tabelës nr. 6, me përjashtim të simbolit “g”.

Tabela nr. 7

NJËSITË E PËRDORURA ME SISTEMIN SI, VLERAT E TË CILAVE JANË PËRCAKTUAR EKSPERIMENTALISHT

Madhësia	Njësia		
	Emri	Simboli	Përkufizime
Energjia	Elektrovolt	eV	Elektron volt është energjia kinetike e fituar nga kalimi i një elektroni për një ndryshim potenciali prej 1 volt në vakum.
Masa	Masa atomike e unifikuar	u	Njësitë e masës atomike të unifikuar janë të barabarta me 1/12 e masës së një atomi të nuklidit ¹² C.

Tabela nr. 8(a)

NJËSITË LIGJORE TË MATJES, LEJUAR VETËM PËR PËRDORIME SPECIFIKE

Fusha e aplikimit	Njësia			
	Emri	Vlera e përafruar		Simboli
Shenjat e trafikut rrugor, matja e distancës dhe e shpejtësisë	milje	1 milje =	1 609 m	mile
	jard	1 yd =	0,9144 m	yd
	këmbë	1 ft =	0,3048 m	ft
	inç	1 in =	$2,54 \times 10^{-2}$ m	in
Shpërndarja e birrës, mushtit, qumështit n1% kontejnerë të kthyeshëm	pint	1 pt =	$0,5683 \times 10^{-3}$ m ³	pt
Transaksioni në metale të çmuara	troy ounce	1 oz tr =	$31,10 \times 10^{-3}$ kg	oz tr

Tabela nr. 8(b)

NJËSITË LIGJORE TË MATJES MADHËSITË, EMRAT, SIMBOLET DHE VLERAT E PËRAFËRTA

Gjatësia		
inç	1 in	$= 2,54 \times 10^{-2} \text{ m}$
këmbë	1 ft	$= 0,3048 \text{ m}$
milje	1 mile	$= 1\,609 \text{ m}$
jard	1 jard	$= 0,9144 \text{ m}$
Sipërfaqja		
këmbë në katror	1 sq ft	$= 0,929 \times 10^{-1} \text{ m}^2$
akre	1 ac	$= 4\,047 \text{ m}^2$
jard në katror	1 sq yd	$= 0,8361 \text{ m}^2$
Volumi		
fluid ounce	1 fl oz	$= 28,41 \times 10^{-6} \text{ m}^3$
gllënjë	1 gill	$= 0,1421 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
pint	1 pt	$= 0,5683 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
kuart	1 qt	$= 1,137 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
gallon	1 gal	$= 4,546 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
Mas		
ounce (shmangës)	1 oz	$= 28,35 \times 10^{-3} \text{ kg}$
troy ounce	1 oz tr	$= 31,10 \times 10^{-3} \text{ kg}$
paund	1 lb	$= 0,4536 \text{ kg}$
Energjia		
therm	1 therm	$= 105,506 \times 10^6 \text{ J}$

Tabela nr. 8(c)

NJËSITË E MATJES, LEJUAR VETËM PËR PËRDORIME SPECIFIKE

Fusha e aplikimit	Njësia			
	Emri	Vlera e përafëruar		Simboli
Navigimi detar	pash detar (fathom)	1 fm =	1,829 m	fm
Birrë, musht, limonada, ujë, lëngje frutash në kontejnerë të kthyeshëm	pint	1 pt =	$0,5683 \times 10^{-3} \text{ m}^3$	pt
	fluid ounce	1 fl oz =	$28,41 \times 10^{-6} \text{ m}^3$	fl. oz
pije	gllënjë	1 gill =	$0,142 \times 10^{-3} \text{ m}^3$	gill
Mallra të shitura me shumicë	ounce (shmangës)	1 oz =	$28,35 \times 10^{-3} \text{ kg}$	oz
	paund	1 lb =	0,4536 kg	lb
furnizim me gaz	therm	1 therm =	$105,506 \times 10^6 \text{ J}$	therm